

V E N D I M
Nr. 37, datë 16.5.2002

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË
STABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Integrimin European dhe Paktin e Stabilitetit, në përputhje me detyrimet që lindin nga zbatimi i procesit të integrimit european dhe Paktit të Stabilitetit dhe, në veçanti, nga hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.

II. Komisioni ndërtohet sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme, në përbërje të të cilit do të përfshihen edhe përfaqësues të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, si Komisioni i Përhershëm për Politikën e Jashtme, Komisioni i Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin, Komisioni i Përhershëm i Rendit dhe SHISH-it, Komisioni i Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet, si dhe Komisioni i Përhershëm i Mbrojtjes. Ky Komision do të veprojë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

III. Qëllimet kryesore të këtij Komisioni janë:

1. Nxitja e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European dhe zbatimi i Paktit të Stabilitetit si instrument që e afron vendin tonë me Europën.

2. Bashkërendimi ndërparlamentar i komisioneve të përhershme të Kuvendit për synimet e këtij Komisioni.

3. Koordinimi i politikave të Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera të lidhura me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe Paktin e Stabilitetit.

4. Përputhja e legjislacionit shqiptar me standardet dhe kërkesat e Bashkimit European.

5. Forcimi i bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë, Parlamentit European, asambleve parlamentare të KE-së dhe OSBE-së, për të ndikuar në nxitjen e zbatimit të Paktit të Stabilitetit dhe përshpejtimin e procesit të stabilizim-asocimit.

6. Krijimi i bërthamave parlamentare për parandalimin e konflikteve në rajon dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet parlamenteve.

7. Forcimi i bashkëpunimit me parlamentet e rajonit, shkëmbimi i përvojave në procesin e stabilizim-asocimit.

8. Plotësimin e kushteve dhe detyrimeve për hapjen e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në fushën politike, ekonomike, të drejtësisë dhe mjedisit.

9. Transparenca ndaj opinionit publik, si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në zbatimin e procesit të integrimit european dhe Paktit të Stabilitetit.

10. Organizimi i rregullt i debateve parlamentare për rëndësinë e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut njerëzor, me qëllim mbajtjen e këtij problemi vazhdimisht në axhendat politike kombëtare.

11. Informimi i Kuvendit me politikat e demokracisë, sigurisë e të zhvillimit ekonomik në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe iniciativave të tjera rajonale, si SEECEI, SEECP, Adriatiko-Joniane etj.

IV. Afati i veprimtarisë së Komisionit përcaktohet në përputhje me zhvillimet dhe nevojat e proceseve të lartpërmendura.

V. Komisioni çdo 45 ditë njofton Kuvendin për punën e tij.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi